



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1273/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit NPT Lindi me numër unik identifikues 810587561 me numër regjistrimit biznesit 80575769 me seli në Prizren kundër debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1986/22 datës 28.07.2023, me datën 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit NPT Lindi, me numër unik identifikues 810587561 me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr. 1986/22 i datës 28.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkalles e Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 1986/22 dt.28.07.2023, ka Pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) me seli ne Prishtinë, ka anuluar urdhrin përmbarimor nr.29/22 dt.19.01.2022 i lejuar nga përmbaruesi privat Isa Gacaferri, dhe ka përfunduar në tërsi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes esenciale te dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e kreditorit, aktvendimin e ankimuar ta anuloj, ashtu që urdhri përmbarimor P.nr.29/22 dt.19.01.2022 të mbetet në fuqi, ose ëndën ta kthej në rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NPT Lindi me numër unik identifikues 810587561 me numër regjistrimit biznesit 80575769 me seli në Prizren, me datën 18.01.2022, ka paraqitur propozim për përmbaerim ndaj debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) me seli ne Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.22-SHV01-001-32 e datës 12.01.2022

Përmbaeruesi Privat Isa Gacaferri, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbaerimor P.nr.29/22 datës 19.01.2022, ka lejuar përmbaerimin, me të cilën detyrohet debitorit që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga fatura ti paguaj shumën prej 18,456.65€, me kamatë vonesë prej 8% në vit, duke llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaerimore.

Kundër urdhrin përmbaerimor debitorit ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërsi urdhrin përmbaerimor, me arsyetimin se dokumentet e bashkangjitura propozimit për përmbaerim nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm sikurse parashihet me nenin 29 të LPP-së, pasi që fatura kontestuese nuk është bashkangjitur në origjinal apo kopje të vërtetuar, po ashtu propozimi për përmbaerim nuk i përmban shënimet e caktuara sikurse parashihet me nenin 29, 37, 40 të LPP-së, i propozon gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbaerimor P,nr.29/22 dt.19.01.2022.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori, me arsyetimin se e kundërshton prapësimin e debitorit dhe thekson se nga fatura debitorit është furnizuar me mall nga firma jonë prandaj kjo faturë duhet paguar, se kjo sasi e oksigjenit është e kreditorit vërtetohet nga fletë dërgesat nga personi i autorizuar i QKUK, bashkangjitur gjenden foto ku shihen automjetet e QKUK duke u ngarkuar me oksigjen në firmën tonë, i propozon gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës se Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1986/22 dt.28.07.2023, me të cilin e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit ka anuluar urdhrin përmbaerimor dhe ka përfunduar në tërsi përmbaerimin. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe urdhri përmbaerimor duhet te anulohet e kjo mbështetur ne nenin 29 të LPP sepse fatura nr.-SHV01-001-32 datës 12.01.2022 sipas se cilës është caktuar përmbaerimi nuk i plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm për faktin se në rastin konkret nuk mund te vërtetohet se fatura është pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitorit, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë provë tjetër përmes të cilës do mund të vërtetohej se fatura është dorëzuar me rregull dhe është pranuar nga debitorit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës e lëshuar nga kreditori, por e cila faturë nuk është në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 29 par.3 te LPP-së.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Edhe kjo gjykatë vlerëson se fatura numër nr.-SHV01-001-32 datës 12.01.2022, mbi bazën e te cilës është lejuar përmbartimi, nuk është në pajtim me dispozitat ligjore dhe atë nenin 29 par.3 te LPP i cili parasheh që *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”* e po ashtu edhe Udhëzimit administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, e që në rastin konkret kjo faturë nuk është e nënshkruar apo e vulosur nga debitori, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e pranimin të një dokumenti ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka prova se debitori i ka pranuar këtë faturë në mënyrë të rregullt, ashtu që e njëjta konsiderohet se është lëshuar njëanshëm.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet e kreditorit por vlerësoi se të njëjtat janë të pabazuara dhe të paargumentuara me prova juridikisht të vlefshme, sepse nuk mund të konsiderohen tani paragonat apo fletë dërgesat si dokumente të besueshme për tu lejuar përmbartimi, pasi që propozimi për përmbartim i kreditorit është iniciuar në bazë të faturës SHV01-001-31 dt.12.01.2022.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1273/23 me datë 02.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha